



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-24306/23
Kaçanik, 27.09.2023

Mbështetur në nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 59 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.60/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të pikës 5 paragrafi 4.3 e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023, 01Nr. 60/01-32951/23 të datës 29.12.2022, të Propozim Vendimit të Kryesuesit të Kuvendit të datës 15.09.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËR REALIZIMIN E NJË VIZITE STUDIMORE E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE NË REPUBLIKËN E MALIT TË ZI

1. Me këtë Vendim, vendoset të realizohet një vizitë studimore e Anëtarëve (Këshilltarëve) të Kuvendit të Komunës Kaçanik, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi.
2. Vizita studimore nga pika 1. e këtij Vendimi, realizohet me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunave.
3. Për përgatitjet e nevojshme për realizimin e vizitës nga pika 1. e këtij vendimi do të kujdesen, Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Shefat e GP të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.
4. Shpenzimet për realizimin e vizitës nga pika 1 e këtij vendimi do t'i bartë Komuna e Kaçanikut, ndërkaq do të kujdeset t'i zbatoj, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për Procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Kryesuesi i Kuvendit;
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Makfire Malsiu

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: Monday, October 16, 2023 2:48 PM
To: Kemajl Murseli
Cc: Besim Murtezani; Xhevat Tafa; Makfire Malsiu
Subject: Njoftim....

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Komunës së Kaçanikut, si në vijim:

- Vendimi 01 Nr. 60/01-24306/23 për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të Kuvendit të Komunës Kaçanik, në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Malit të Zi, vendim i datës 27.09.2023, vlerëson se akti i komunës nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë;

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL
Tel: 038 200 64 144
E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net
Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja